



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 836/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Xhevdet Abazi kryesues, Nenad Lazić dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Gjilan, për shkak të bartjes së votave nga një subjekt në tjetrin, gjatë procesit zgjedhor, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 12.11.2013, mori këtë:

### VENDIM

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e Partia Demokratike të Kosovës (PDK), dega në Gjilan.

### Arsyetim

Me datën 12.11.2013, subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), ka parashtruar ankesë në PZAP, në të cilën ankesë pretendohet se në Vendvotimin me nr.0430D/R1 dhe në VV nr.0430D në fshatin Livoqi i ulët gjatë plotësimit të Formularit të FPR-së, është bërë një gabim teknik ku në vend që ti shënohen 145 vota PDK-së, për asamble komunale i janë shënuar subjektit politik Social Demokratja SD, andaj kërkojmë që të behet rinumërimi i këtyre kutive, thuhet në pretendimet e ankimore.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur si provë fotografi.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

### Ankesa është e pabazuar

Me nenin 118.4 LZP-së, parashihet se: *“Mund te apelojen vendimet e PZAP-it, sikurse PZAP-i mund ti rishikoj cilindo nga vendimet e marra pas prezantimit të fakteve të reja nga pala e interesuar”*.

PZAP-i konstatoi se subjektit politik PDK, nuk ka bashkangjitur prova të mjaftueshme me të cilën mund të vërtetonte pretendimet ankimore se janë barturë votat nga një subjekt në tjetrin. PZAP-i, konstatoi se një pretendim i tillë është i pa argumentuar në prova relevante, andaj në kuptim të nenin 3.6 pika c) të Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it si dhe nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, lidhur me ankesën e lart përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

A nr. 836/2013 më datën 12.11.2013.

**Kryesuesi i Panelit  
Xhevdet Abazi**



***Këshillë Juridike:*** Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.